

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

---

### Xhelozia mbrojtëse / *el-Gira* / الْغَيْرَةُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"

رُدُّوْهَا عَلَيَّ فَطَفِقَ"

“(Sulejmani ﷺ tha:) ‘M’i ktheni ata,’ dhe nisi t’i godiste këmbëve dhe qafave.”<sup>1</sup> (Saad, 33)

*Gajrah* (xhelozia mbrojtëse) ka të bëjë me mosgatishmërinë për të pranuar diçka nga shqetësimi<sup>2</sup> dhe me padurimin e shkaktuar nga zelli dhe ambicia<sup>3</sup>. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është *gajrah* e robit lidhur me atë që i ka ikur - që:

- Të rikthejë atë
- Të kompensojë humbjen e saj<sup>4</sup>
- Dhe të zvogëlojë pasojat e humbjes së saj

---

<sup>1</sup> Ajeti u citua këtu nga shejhu (el-Harawi), meqë xhelozia e Sulejmanit ﷺ për raportet e tija me Allahun ishte ajo që e shtyu t’i sakrifikonte kuajt të cilët, me bukurinë që kishin, e shpërqendruan nga adhurimi. Interpretimi tjetër është se ai fshiu (nuk preu) këmbët dhe qafat e tyre për të treguar përulësi dhe keqardhje para Zotit.

<sup>2</sup> Mosgatishmëri për të pranuar çfarëdo pengese a shpërqendrimi në rrugën e Allahut.

<sup>3</sup> Të mos lejosh të mundesh nga të tjerët në garën drejt Allahut.

<sup>4</sup> Dallimi mes kësaj dhe pikës paraprake është se nganjëherë s’ka kompensim për humbjen e disa veprave të caktuara, kështu që duhet të kompensoh në mënyra të tjera për humbjen e pësuar. Po ashtu do të duhej të kompensoje për bërjen e gjynaheve ose bërjen e gjërave/veprimeve të papërshtatshme.

Niveli i dytë është *gajrah* e ndjekësit të shtegut të pastrimit shpirtëror, e cila ka të bëjë me humbjen e kohës<sup>5</sup>. Kjo është një *gajrah* dëmtuese, meqë koha:

- Humbet shpejt<sup>6</sup>
- Menaxhohet vështirë
- Dhe kthehet ngadalë<sup>7</sup>

Niveli i tretë është *gajrah* e ‘*Arifit*<sup>8</sup> që ka të bëjë me:

- Të parët<sup>9</sup> që mbulohet nga një perde
- Gjendjen e brendshme të errësuar nga njollosja
- Dhe me frymëmarrjen që ka qenë e varur në shpresë ose ka kërkuar shpërblime<sup>10</sup>

---

<sup>5</sup> Ndjekësi i shtegut të pastrimit shpirtëror nuk ndien keqardhje vetëm për humbjen e punëve të mira dhe padrejtësitë e bëra, por dhe për frymën e harxhuar në gjëra të tjera veç ndjekjes së kënaqësisë së Allahut.

<sup>6</sup> Në disa dorëshkrime, shejhu (el-Harawi) tha “humbet shpejt”, ndërsa në këtë dorëshkrim ai tha “hidhërohet shpejt”, gjë që nënkupton temperament, por që përfundimisht ka kuptimin e njëjtë si “humbet shpejt”.

<sup>7</sup> Jo se kthehet koha, por kthehet gjendja nga e cila bie personi, kur të humbë kohën.

<sup>8</sup> Mund të përkthehet si “gnostik”, por, për shkak të disa konotacioneve negative të kësaj fjale, unë (Hatim el-Haxh) preferoj të përdoret origjinali në arabisht, që do të thotë “njohës”, që në terminologjinë e Mjeshtërve të Shtegut nënkupton një posedues të dijes së brendshme të një zemre të pastër, të dobishme, dhe reformuese.

<sup>9</sup> Disa nga të vërtetat e besimit që u janë të qarta atyre si qartësia e të parit me sy.

<sup>10</sup> Ndërsa vëmendja është dashur të përqendrohet në arritjen e kënaqësisë dhe dashurisë së Zotit.